Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Egzoni Zariqi	**13.12.2023**	**27.12.2023**	**2023/1002**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

1. Me datë 17.11.2023, AK-Komuna e Kamenices ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK konkretisht: Formularin B58 ku ka eliminuar OE Nika Pro-Ing nen arsyeshmerine qe Oferta e juaj nuk eshte vleresuar pasi qe për aktivitetin e njejt ju eshte nderprere kontrata dhe nuk mund te kontraktoheni per kete aktivitet dy here.

2. Me datë: 22.11.2023 13:35, OE Nika ProIng ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim lidhur me proceduren: KM653-23-11692-5-2-1

3. Me datë 29.11.2023, AK-Komuna e Kamenices ka paraqitur Vendimin për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim: Konkretisht: Vendim ne kerkesen per rishqyrtim.pdf ka kthyer përgjigje për proceduren: KM653-23-11643-5-2-1 dhe jo për proceduren ankuese nga OE Nika ProIng KM653-23-11692-5-2-1.

4. Me datë 11.12.2023, OE Nika ProIng ka paraqitur Ankesë pranë OSHP-së lidhur me proceduren: KM653-23-11692-5-2-1

Sqarim plotësues: deri në këtë hap nuk është verejtur se ka ndonje shperputhje në mes afateve kohore të rregullta dhe trajtimit të dokumentacionit, e vetmja shperputhje ne mes dokumentacionit dhe verifikimit te tyre eshte se AK nuk ka kthyer nje pergjigje mbi proceduren: Ndërtimi i tereneve sportive në kuadër të institucioneve arsimëre Roganë, Karaqevë, Kamenicë,Petrit dhe Topanicë-

Ritenderim me numër: KM653-23-11692-5-2-1.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

OE Nika ProIng ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim dhe në Ankesë / Pretendon se AK-Komuna e Kamenices ka shkelur dispozitat e Ligjit: Nenin 1, Nenin 6 dhe Nenin 7 të LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

OE ka paraqitur ankese me daten 22.11.2023 ne pretendimin e vetem ankimor, ku e ka atakuar arsyen e anulimit te procedures, duke specifikuar qe askund ne LPP dhe ne Rregullore nuk parashihet ky aspekt.

Me datë 29.11.2023, AK Komuna e Kamices ka kthyer Vendimin për rishqyrtimin e procedures se prokurimit: Ndërtimi i tereneve sportive në kuadër të institucioneve arsimëre Roganë, Karaqevë, Kamenicë,Petrit dhe Topanicë-Ritenderim me numër: KM653-23-11692-5-2-1, duke e bashkangjitur vendimin për Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë, Koretin,Karaçevë,Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë-Ritenderim procedure kjo tjeter krahas asaj se cka OE ka atakuar ne Kerkese për rishqyrtim.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Me datë 11.12.2023 OE Nika Pro-Ing ka paraqitur ankesë në OSHP për proceduren: Ndërtimi i tereneve sportive në kuadër të institucioneve arsimëre Roganë, Karaqevë, Kamenicë,Petrit dhe Topanicë-Ritenderim me numër KM653-23-11692-5-2-1, nen arsyetimin qe AK nuk është përgjigjur mbi pretendimet e dates 22.11.2023 ne Kerkesen për rishqyrtim dhe se AK e ka eliminuar Operatorin Ekonomik mbi arsyetimin i cili nuk ka baze as ne Ligj e as ne Rregullore.

Eksperti Shqyrtues paraqet se:

Pretendimi ankimor i OE Nika Pro-Ing është i bazuar në dy arsyeje:

Autoriteti Kontraktues nuk mund te eliminioi nje Operator Ekonomik ose Grup të Operatoreve Ekonomik për një kriter i cili nuk është paraqitur në Formularin e Tenderit, baza ligjore e ketij pretendimi te bazuar është: Rregullorja 001/2022, konkretisht nenin 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues duhet t'i kthei Vendimin – Kërkesës për rishqyrtim pasi të pranoi Kërkesën ne një afat 3+3 ditë, baza ligjore qe pretendimi eshte i bazuar është: Neni 108/A. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pika 6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë, kjo gjendet në: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E KAMENICËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Egzoni Zariqi